

L I G J
Nr. 8610, datë 17.5.2000

PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim parandalimin e pastrimit të parave, të rrjedhura nga veprimtaria kriminale, si dhe luftën kundër krimit financiar.

Neni 2
Përkufizime

Përveçse kur përcaktohet ndryshe, në këtë ligj termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

1. “Pastrim i parave” është qarkullimi dhe riqarkullimi i parave të rrjedhura nga veprimtari kriminale, më poshtë të quajtura “të papastra”.

Pastrimi i parave përfshin:

a) depozitimin, tjetërsimin, transferimin dhe /ose këmbimin e parave, me qëllim maskimin, fshehjen ose mohimin e përkatësisë apo origjinës së pasurisë, që rrjedh nga veprimtaria kriminale;

b) fitimin e së drejtës së pronësisë kur subjekti ka dijeni mbi çdo lloj pasurie, që rrjedh nga veprimtaria kriminale apo nëpërmjet përdorimit të parave të papastra;

c) ndërmjetësimin në favor të një personi tjetër për depozitimin, tjetërsimin, transferimin dhe/ose këmbimin e parave, me qëllim maskimin, fshehjen ose mohimin e përkatësisë apo origjinës së pasurisë, që rrjedh nga veprimtaria kriminale;

ç) pjesëmarrjen si ortak në personin juridik, me qëllim maskimin, fshehjen ose mohimin e përkatësisë apo origjinës së pasurisë, që rrjedh nga veprimtaria kriminale;

d) bashkëpunimin në kryerjen e veprimeve të mësipërme, me veprim ose mosveprim, të kryera apo të mbetura në tentativë, si dhe fshehjen e pasojave të veprimtarisë kriminale. Këtu përfshihen edhe bashkëpunimi ndërmjet subjektit dhe klientit kriminal, që kryen veprën penale të pastrimit të parave, duke përfshirë dhënien e informacionit nga subjektet sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

2. “Klient”, për efekt të këtij ligji, është personi fizik (tregtar dhe jotregtar-individ) dhe personi juridik, rezident ose jorezident, shqiptar ose i huaj, publik ose privat.

3. “Autoritet Përgjegjës”, në mbështetje dhe në zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative është “Agjencia e Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave” pranë Ministrisë së Financave. Statusi juridik dhe pozicioni i këtij “Autoriteti Përgjegjës” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. “Cash”, në mbështetje dhe në zbatim të këtij ligji dhe akteve të tjera normative është monedha në qarkullim, duke përfshirë kartmonedhën dhe monedhën metalike, kombëtare dhe/ose të huaj.

5. “Pezullim i veprimit financiar”, në mbështetje dhe në zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative është ndërprerja e veprimit financiar nga “Autoriteti Përgjegjës”.

Neni 3
Subjektet

1. “Subjektet” janë personat fizikë ose juridikë, të parashikuar në Kodin Civil të Republikës së

Shqipërisë, që në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative, kryejnë veprimtaritë e përcaktuara në këtë ligj.

Subjekte të tilla janë:

a) Bankat dhe subjektet, që kryejnë veprimtari bankare dhe financiare, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;

zyrat e këmbimeve valutore;

bursat;

ç) fondet e investimeve;

d) shoqëritë e sigurimeve dhe/ose risigurimeve dhe entet e tjera ligjore, që ushtrojnë veprimtari sigurimi dhe/ose risigurimi, të autorizuar nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve;

dh) institucionet përgjegjëse në procesin e privatizimit;

e) shërbimet postare, si dhe ndërmjetësuesit e tjerë që kryejnë shërbime pagesash;

ë) shoqëritë që kryejnë veprimtari tregtare të lojrave të fatit apo kazinotë;

f) ekspertët kontabël të autorizuar;

g) çdo person fizik dhe juridik, veprimtaria tregtare e të cilit ka të bëjë me:

- tregtinë e mjeteve të transportit;

- veprimtaritë e transportit dhe speditonit;

- tregtimin e sendeve me vlerë dhe/ose antike;

- vlerësimin e pasurive të paluajtshme;

- administrimin e pronës së të tretëve;

- veprimtarinë tregtare me metale të çmuar ose gurë të çmuar;

- agjencitë e udhëtimeve;

gj) avokatët, noterët dhe përfaqësuesit me prokurë;

h) organet doganore e tatimore;

i) filialet, degët, agjencitë apo zyrat e përfaqësimit të subjektit të huaj; brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

j) zyrat që evidentojnë transferimin apo tjetërsimin e pasurive.

Neni 4

Procedurat e identifikimit

1. Të gjitha subjektet e këtij ligji identifikojnë klientët, përpara kryerjes së veprimit financiar mbi shumat e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

Subjektet identifikojnë klientët edhe në rastet kur ka të dhëna për pastrim të parave, të përfituara nga veprimtaria kriminale, megjithëse shuma e veprimit financiar mund të jetë poshtë kufijve të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji.

2. Identifikimi i klientëve nga subjektet realizohet nëpërmjet regjistrimit dhe mbajtjes, në dosje të veçantë, të të dhënave të mëposhtme:

a) për personin fizik jotregtar (individ): emri, mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi i përkohshëm dhe i përhershëm, si dhe numri dhe lloji i dokumentit zyrtar të identifikimit dhe organi që e ka lëshuar atë, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar;

b) për personin fizik tregtar: emri, mbiemri, numri dhe data e vendimit të gjykatës për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të subjektit, numri dhe data e lejes së ushtrimit të veprimtarisë nga organet tatimore, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar;

c) për personin juridik: emri, numri dhe data e vendimit të gjykatës për regjistrimin si person juridik, numri i lejes së ushtrimit të veprimtarisë nga organet tatimore, selia e përkohshme dhe e përhershme, natyra e veprimtarisë tregtare, qëllimi, lloji, data, shuma dhe monedha e veprimit financiar, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar;

ç) për përfaqësuesin ligjor të klientit: emri, mbiemri, datëlindja, vendlindja, numri i dokumentit zyrtar të identifikimit dhe lëshuesi i këtij dokumenti, akti i përfaqësimit (prokura), si dhe të gjitha ndryshimet e bëra deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar.

Në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative “Autoriteti Përgjegjës” përcakton formën dhe procedurën e regjistrimit të të dhënave.

3. Dokumentacioni i identifikimit i të gjithë klientëve mbahet në origjinal dhe është i vlefshëm brenda afatit ligjor të vlefshmërisë së tij. Në rast se në çastin e kryerjes së veprimit financiar nuk

deklarohet shuma, subjektet e mësipërme identifikojnë klientin, sapo kjo shumë të deklarohet.

4. Të gjithë klientët, të cilët kërkojnë të kryejnë një veprim financiar mbi shumën e përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji, deklarojnë përfutuesit përfundimtarë të fruteve të pronës, burimin, natyrën dhe të ardhurat e përfutura nga qarkullimi i parave, duke përjashtuar pagesat e bëra për sigurimet shoqërore.

Neni 5

Raportimi tek “Autoriteti Përgjegjës”

1. Subjektet e përcaktuara në këtë ligj regjistrojnë të gjitha veprimet financiare në cash të të gjithë klientëve për shumat mbi 2 000 000 (dy milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera, të huaja.

Pas regjistrimit të këtyre veprimeve, në rast se ka elementë të dyshimit për pastrimin e parave, sipas përcaktimit të bërë në këtë ligj, subjektet i raportojnë “Autoritetit Përgjegjës” jo më vonë se 48 orë.

2. Subjektet, e përcaktuara në këtë ligj, i raportojnë “Autoritetit Përgjegjës” për të gjitha rastet e veprimeve financiare në cash dhe/ose transfertave të fondeve për shuma mbi 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera, të huaja.

3. Subjektet, e përcaktuara në këtë ligj, i raportojnë “Autoritetit Përgjegjës” për të gjitha veprimet financiare të klientëve mbi shumën prej 2 000 000 (dy milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja, në rastet kur vërejnë:

a) parregullsi në veprimet financiare të klientit, të përcaktuara në nenin 2 pika 1, veçanërisht në depozitimet, transferimet, dhe/ose këmbimet e parave, si dhe emëtimin e instrumenteve të negociueshme (çek, kambial dhe prentim pagese);

b) rrethana të ndërlukuara, të pazakonta dhe të pajustificuara, në veprimet financiare;

c) se veprimet financiare të klientëve nuk justifikohen nga pikëpamja ekonomike dhe ligjore;

ç) njoftime, se paratë rrjedhin nga veprimtaria kriminale;

d) se ka të dhëna për pastrimin e parave, që kanë lindur pas kryerjes së veprimit financiar, si dhe në çdo rast tjetër që nuk përfshihet më sipër, por ekzistojnë elementet e kryerjes së veprës penale të pastrimit të parave.

4. Subjektet e këtij ligji njoftojnë Autoritetin Përgjegjës për çdo të dhënë që pohon ose mohon dyshimet.

5. Të dhënat për “Autoritetin Përgjegjës” jepen vetëm nga administratorët, zyrtarët ose nëpunësit e autorizuar të subjekteve.

6. Në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative, “Autoriteti Përgjegjës” përcakton formën dhe procedurën e verifikimit dhe të raportimit të të dhënave.

Neni 6

Detyrimet dhe të drejtat e subjekteve

1. Subjektet, e përcaktuara në këtë ligj, ndalohen të njoftojnë klientin për procedurat e verifikimit të dyshimit për pastrimin e parave, në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative.

Subjektet, e përcaktuara në këtë ligj, detyrohen të mbajnë dhe të ruajnë:

a) të gjithë të dhënat për identifikimin e klientit, për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga data e përfundimit të marrëdhënieve juridike civile me subjektin;

b) të dhënat, njoftimet, raportimet për veprimin financiar në emër të klientit për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga data e kryerjes së veprimit financiar.

2. Në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative, subjektet kanë të drejtë të mos e kryejnë veprimin financiar në rast se:

a) klienti ose klientët nuk sigurojnë identitetin e plotë të tyre;

b) provohet anonimat i tyre ose identiteti fiktiv;

c) kur kanë arsye (prova) që i shtyn të besojnë se veprimi financiar është i lidhur me pastrimin e parave, sipas përcaktimit të bërë në nenin 2 pika 1 të këtij ligji.

Neni 7

1. Në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative, subjektet e këtij ligji detyrohen:

a) të caktojnë një drejtues të nivelit të lartë në qendër, filial, degë, agjenci ose zyrë përfaqësimi (në rast se kanë të tilla), ku të gjithë nëpunësit dhe punonjësit e tjerë raportojnë të dhëna të mjaftueshme, që mund të jenë element i përcaktimit të bërë në nenin 5 të këtij ligji;

b) të sigurojnë krijimin e një qendre të grumbullimit të të dhënave;

c) të përgatisin dhe të zbatojnë rregullore dhe udhëzime të brendshme të nevojshme për parandalimin e pastrimit të parave;

ç) të informojnë periodikisht nëpunësit dhe punonjësit e tyre për procedurat ligjore të veprës penale të pastrimit të parave;

d) të organizojnë periodikisht programe kualifikimi për punonjësit;

dh) të ngarkojnë kontrollin e brendshëm për zbatimin e dispozitave të këtij ligji;

e) të kujdesen që filialet, degët dhe agjencitë e tyre jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të veprojnë në përputhje me këtë ligj.

2. Në rast se numri i personelit të subjekteve, të përcaktuara në këtë ligj, është më pak se 3 (tre) veta, kërkesat e përcaktuara në nenin 7 pika 1, si më sipër, përmbushen nga vetë administratori ose nga personi i autorizuar, punonjës i subjektit.

Neni 8

Detyrat e “Autoritetit Përgjegjës”

1. Në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative, “Autoriteti Përgjegjës”:

a) bën grumbullimin e të gjitha raporteve të sjella nga të gjitha subjektet e përcaktuara në këtë ligj;

b) bën verifikimin e të dhënave të raporteve të subjekteve të përcaktuara në këtë ligj;

c) realizon kontrollin e procedurave, që kanë lidhje me raportin e dërguar nga subjektet e përcaktuara në këtë ligj;

ç) kërkon të dhëna shtesë nga subjektet e përcaktuara në këtë ligj, nëse është e nevojshme;

d) mban, vlerëson, nxjerr në pah dhe ruan njoftimin dhe të dhënat e paraqitura;

dh) gjobot, pezullon me qëllim parandalimin e çdo veprimi, transferimi ose kalimi të pasurisë, që rrjedh nga veprimtaria kriminale;

e) merr masat e nevojshme verifikuese;

ë) bashkëpunon me autoritetet kombëtare dhe ndërkombëtare, për t’i njoftuar për identifikimin, gjetjen e burimit, bllokimin dhe sekuestrimin e pasurisë;

f) merr masat për përdorimin e teknikave verifikuese në identifikimin dhe në gjetjen e burimit të të ardhurave, si dhe mbledh të dhëna për to;

g) vlerëson rrezikshmërinë e veprës penale të pastrimit të parave, në përputhje me zhvillimet teknologjike, të cilat favorizojnë ruajtjen e anonimatit të veprimit financiar dhe merr masat e nevojshme për parandalimin e pastrimit të parasë, me anë të këtyre teknologjive.

2. “Autoriteti Përgjegjës” vepron brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së raportit nga subjekti.

Me veprim të “Autoritetit Përgjegjës” do të kuptohet vlerësimi i raportit të paraqitur nga subjekti dhe identifikimi i rrezikut të mundshëm në fushën bankare dhe financiare.

“Autoriteti Përgjegjës”, pasi ka vlerësuar dhe grumbulluar fakte të mjaftueshme për ekzistencën e veprës penale, bën kallëzimin në organin e prokurorisë.

3. “Autoriteti Përgjegjës” mban dhe ruan të dhënat, si dhe dokumentacionin tjetër ligjor për veprimet financiare, për një periudhë jo më pak se 5 vjet.

4. Nëpunësit dhe punonjësit e “Autoritetit Përgjegjës” përdorin njoftimin dhe ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të marra vetëm në funksion të ushtrimit të detyrave dhe të pushteteve të parashikuara në këtë ligj.

5. “Autoriteti Përgjegjës” i kushton vëmendje të veçantë rrezikshmërisë së figurës të krimit të pastrimit të parave, kur zhvillimet teknologjike mund të favorizojnë ruajtjen e anonimatit të veprimit

financiar dhe merr masat e nevojshme për parandalimin e pastrimit të parasë, me anë të këtyre teknologjive.

Neni 9

Bashkëpunimi me autoritetet e zbatimit të ligjit.

Në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative, subjektet bashkëpunojnë me organet e drejtësisë, në masën që u lejohet nga ligji përkatës në fushën e konfidencialitetit të veprimeve financiare të klientit.

Neni 10

Raportimi i transaksioneve në pikat e kalimit kufitar.

1. Individët, rezidentë ose jorezidentë, që hyjnë e dalin në dhe nga territori i Republikës së Shqipërisë, deklarojnë detyrimisht, shumat në cash ose çeqe udhëtari, në dhe mbi shumën 10 000 (dhjetë mijë) USD ose kundërvlerën në monedha të tjera.

2. Individët, qytetarë të huaj, që vizitojnë përkohësisht Shqipërinë, mund të nxjerrin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë valutë cash ose çeqe udhëtari, deri në masën e deklaruar, kur kanë hyrë, që justifikohet me paraqitjen në doganë të deklarates përkatëse.

3. Organet doganore raportojnë menjëherë “Autoritetin Përgjegjës” në të njëjtën formë dhe mënyrë, sikurse parashikohet për subjektet e tjera të përcaktuara në këtë ligj, në rastet kur:

- a) marrin njoftim për veprimtarinë e pastrimit të parave;
- b) vihet re moszbatimi i këtij ligji

Neni 11

Raportimi për veprimtaritë bankare

Për veprimtaritë bankare që përfshijnë transaksione, transfertat dhe veprime të tjera ndërkombëtare nga bankat shqiptare ose subjektet e licencuara, që kryejnë veprimtari financiare dhe bankare në Shqipëri, veprohet në përputhje me aktet nënligjore përkatëse të lëshuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 12

Mbrojtja e të drejtave të subjekteve

Subjektet e përcaktuara në këtë ligj ose personat përfaqësues të këtyre subjekteve, si dhe punonjësit e tyre, që raportojnë me mirëbesim, përjashtohen nga përgjegjësia ligjore (penale dhe civile) e ruajtjes së sekretit (përfshirë dhe atë bankar) dhe e të dhënave tregtare konfidenciale të klientëve.

Neni 13

Detyrimet e autoriteteve mbikëqyrëse

Autoritetet mbikëqyrëse të të gjitha subjekteve të përcaktuara në këtë ligj, në rast se gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre institucionale vërejnë se ka elemente të pastrimit të parasë, njoftojnë “Autoritetin Përgjegjës”, për të parandaluar pastrimin e parave, sipas së njëjtës formë dhe mënyrë, sikurse parashikohet për të gjithë subjektet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 14

Kundërvajtjet administrative

1. Kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve nga subjektet që veprojnë në kundërshtim me nenin 5 dhe nenin 6 pika 1 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 1 000 0000 (një milion) lekë, deri në 20 000 0000 (njëzet milionë) lekë.

2. Kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve nga drejtuesit e nivelit të lartë të subjekteve të

autorizuara sipas nenit 7 pika 1 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

3. Kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve nga personat e punësuar pranë subjekteve të përcaktuara në këtë ligj, të cilët qëllimisht:

a) bashkëpunojnë në fshehjen ose maskimin e natyrës së veprimit financiar, të origjinës së tij, në ndryshimin e përcaktimit të burimit të parave të rrjedhura drejtpërdrejt ose tërthorazi nga veprimtaria kriminale;

b) përpiqen të pranojnë një identitet të rremë;

c) me vetëdije prishin ose ndryshojnë regjistrat dhe nuk raportojnë transfertat ndërkombëtare të fondeve ose të letrave me vlerë;

d) të cilat nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 300 000 (treqind mijë) lekë.

4. Gjoha në çdo rast vendoset nga “Autoriteti Përgjegjës”.

Procedura e ankimit dhe ekzekutimit të vendimeve për kundërvajtjet administrative bëhet në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.11993 “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 15

Bashkëpunimi me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare

1. Në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative, “Autoriteti Përgjegjës” dhe organizatat ose institucionet ndërkombëtare simotra bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë të dhëna, me qëllim:

a) investigimin dhe marrjen e masave ligjore, që kanë për qëllim konfiskimin e mjeteve dhe të ardhurave të rrjedhura nga veprimtaria kriminale;

b) dhënien e ndihmës maksimale në identifikimin dhe me gjetjen e burimit të mjeteve, të të ardhurave dhe të pasurive të tjera, që do t'i nënshtrohen konfiskimit. Kjo ndihmë do të realizohet në përputhje me ligjet përkatëse të secilit vend.

2. “Autoriteti Përgjegjës” dhe organizatat ose institucionet ndërkombëtare simotra i japin njëra-tjetrës ndihmë maksimale të ndërsjellë, në shkëmbimin e dokumenteve ligjore, për personat që u janë nënshtruar masave ligjore dhe konfiskimit.

3. Procedurat e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare simotra për ekstradimin e personave të përfshirë në pastrimin e parave dhe të konfiskimit të pasurive zbatohen në përputhje me dispozitat e Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

4. Të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë nen do të bëhen me shkrim. Mund të përdoren edhe mjete të tjera të telekomunikacionit, të përcaktuara nga “Autoriteti Përgjegjës”.

5. “Autoriteti Përgjegjës” harton programe frytdhënëse, ku përfshihet bashkëpunimi dhe asistenca e ndërsjellë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave në vende të ndryshme.

6. “Autoriteti Përgjegjës” ka të drejtë të marrë pjesë dhe të nënshkruajë marrëveshje.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2636, datë 26.5.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.